

PROCESVERBAL
nga seanca e gjashtë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 29.7.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë, ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga Shërbimi Profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, mr. Ivona Mufisheva, Goran Radunović, mr. Argjend Xhelili, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski hapi seancën e gjashtë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 10:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi sa vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së pestë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.7.2025.
2. Propozim-vendim për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit.
3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje e kompjuterave dhe pajisjeve të tjera të IKT.

7. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimi për furnizim të shërbimi, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatim të Ligjit për furnizim publik.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së pestë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.7.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit. Në prezantimin e tij, ai shpjegoi se propozohet të jepet leja për radio me format të specializuar, me maksimum 5% përmbajtje folëse në gjuhën maqedonase dhe serbe, ndërsa pjesa tjetër e programit do të jetë kryesisht muzikë argëtuese, e destinuar për publikun lokal në Prilep. Aplikuesi është Shoqëria Tregtare Radiodifuzive "BUBA MARA" Ranko SHPKNJP Shkup, radiodifuzer që aktualisht transmeton program në nivel rajonal në territorin e Qytetit të Shkupit. Kjo shoqëri tregtare radiodifuzive, më 11 dhjetor të vitit të kaluar, dorëzoi letër interesi Agjencisë, duke shprehur qëllimin për hapje të radiostacioni në komunën e Prilepit. Pas marrjes së përgjigjes pozitive nga Agjencia për Komunikime Elektronike, e cila konfirmoi se ekziston frekuencë e lirë, u përgatit Studimi për arsyeshmëri. Rezultatet e Studimit treguan një nevojë reale për ekzistencën e shërbimi radiofonik në nivel lokal në këtë komunë. Në konkursin publik të shpallur nga Këshilli i Agjencisë, aplikoi vetëm një kandidat, shoqëria që e inicioi procedurën. Pas analizës së kryer nga sektorët kompetente të Agjencisë, u konstatua se kërkesa i plotëson në tërësi të gjitha kërkesat ligjore. Prandaj, propozohet të jepet leje për transmetim në radio në nivel lokal në territorin e komunës së Prilepit.

Znj. Majnova pyeti nëse janë respektuar dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me përqendrimin e paaautorizuar të medias.

Z. Trajçevski shpjegoi se, në pajtim me Ligjin, çdo transmetues që emeton program, pavarësisht nëse është radio apo televizion në nivel rajonal, ka të drejtë të zotërojë dy stacione radio lokale, me kusht që ato të mos jenë të vendosura në zona fqinje. Prandaj, ai konfirmoi se dispozitat ishin marrë parasysh.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendim për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor radio muzikore me format të specializuar, deri në 5% përmbajtje folëse, në gjuhën maqedonase dhe serbe, në të cilën muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese, në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, kandidatit, personit juridik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "BUBA MARA" Ranko SHPKNJP Shkup.

Shërbimi i programit në radio do të transmetohet nëpërmjet frekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (AEK), përkatësisht: 90.3 MHz.

Leja për transmetim në radio në nivel lokal jepet për një periudhë prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i transferohet personi tjetër.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Z. Trajçeovski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës paralajmërimit publik ndaj SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai shpjegoi se gjatë mbikëqyrjes së rregullt administrative është konstatuar se transmetuesi nuk ka respektuar nenin 51 paragrafi (1) të Ligjit, përkatësisht nuk ka ofruar qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme për përdoruesit në informacionin e mëposhtëm të detyrueshëm: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual, adresën e selisë së transmetuesit, të dhënat e kontaktit dhe informacionin në lidhje me organin rregullator kompetent. Duke marrë parasysh se kjo është shkelja e parë në vitin aktual kalendarik, propozohet që Këshilli të shqiptojë masë paralajmërim publik dhe transmetuesi urdhërohet në afat prej 20 ditësh pas marrjes së aktvendimit, të harmonizojë punën e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit. Pas skadimit të afatit, Agjencia të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse TV Kanal Festa ka vepruar në përputhje me paralajmërimin e shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt administrative, nr.10-2654/1 datë 23.6.2025 (i korrigjuar) dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV Kanal Festa SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptojë masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 3 qershor 2025, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas paralajmërimit të shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai shpjegoi se transmetuesi nga Kërçova ka shkelur nenin e Ligjit të lartpërmendur, i cili konsideron që programi duhet të transmetohet në gjuhën maqedonase ose, si në këtë rast, në gjuhën shqipe. Gjatë mbikëqyrjes, u përcaktua se reklama është transmetuar burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe, përkatësisht në gjuhët në të cilat media ka leje për transmetim të programeve. Duke marrë parasysh se kjo është shkelje e parë e Ligjit në vitin aktual kalendarik, propozohet që Këshilli të shqiptojë masë paralajmërimi publik. Transmetuesit do t'i urdhërohet, në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të caktuar, shërbimi do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të konstatuar nëse transmetuesi ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje e kryer të rregullt programore, nr.10-2466/1 datë 12.6.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 3 qershor 2025, reklama për kompaninë "Alba Brixhis" (Alba Bridges), u transmetua burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe ose në maqedonisht, gjuhët në të cilat media transmeton programe në përputhje me lejen.

Në përputhje me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (teksti i pastruar) nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 10 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e nenit 64, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës paralajmërimi publik ndaj transmetuesit SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai shpjegoi se transmetuesi nuk ka respektuar detyrimin ligjor sipas të cilit transmetuesit janë të detyruar të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase dhe së paku gjysma e asaj përqindjeje të transmetohet në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00. Gjatë mbikëqyrjes së kryer më 3 korrik 2025, u konstatua se TV USKANA MEDIA transmetoi vetëm 23.45% program të krijuar burimor nga totali i programit ditor të transmetimit. Përveç kësaj, në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00, transmetuesi ka emetuar 1 orë, 7 minuta dhe

58 sekonda më pak se minimumi i përcaktuar ligjor. Për shkak të këtyre parregullsive të konstatuara, propozohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë paralajmërim publik, me detyrim që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Pas skadimit të afatit, shërbimi kompetent do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të konstatuar nëse transmetuesi ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-2464/1 datë 12.6.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV USKANA MEDIA SHPKNJ Kërçovë, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, sepse më 3 qershor 2025 nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00 nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimin sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të konstatojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Zëvendës udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, mr. Ivona Mufisheva, shpjegoi Propozimin për dhënie të miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera të IKT. Ajo shpjegoi se ky furnizim është parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë dhe i referohet një kontrate me kohëzgjatje prej dy vitesh. Për realizimin e saj nevojiten gjithsej 600.000,00 denarë, nga të cilat: 300.000,00 denarë tashmë janë parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, ndërsa 300.000,00 denarë të tjerë do të sigurohen nëpërmjet Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026. Procedura do të zbatohet në përputhje me Ligjin për Furnizim Publik, nëpërmjet një procedure për furnizim me vlerë të ulët, e cila do të përfundojë me ankand elektronik. Udhëheqësja Mufisheva theksoi se Agjencia ka një numër të madh pajisjesh informacioni dhe komunikimi, të cilat janë të nevojshme për funksionim pa pengesa dhe efikas. Për këtë arsye, Këshillit i propozohet të japë miratimin për fillimin e kësaj procedure.

Z. Xhurovski deklaroi se ai personalisht ka vizituar dhomën e serverëve të Agjencisë duke shikuar pajisjet e instaluara. Duke vepruar kështu, ai pyeti nëse në ambientin ku ndodhet kjo pajisje, do të sigurohet ftohje shtesë, duke marrë parasysh se, sipas përvojës së tij, në ambientet me serverë dhe regjistruar ekzistojnë kushte standarde të temperaturës. Ai vuri në dukje se në specifikimin teknik përfshihet UPS (furnizim me energji të pandërprerë), kështu që pyeti nëse me furnizim publik konkret është përfshirë edhe sistemi për ftohje.

Z. Trajçevski shpjegoi se ky furnizim publik nuk i referohet pajisjeve në dhomën e serverëve, por mirëmbajtjes së pajisjeve të tjera të IKT të Agjencisë. Ai theksoi se dhoma e serverëve mbulohet nga një furnizim publik i veçantë, dhe në këtë drejtim, informoi se në periudhën e kaluar prej rreth 40 ditësh, janë bërë ndërhyrje konkrete në pjesën e ftohjes së dhomës së serverëve, por si pjesë e procedure tjetër për furnizim.

Udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithshme, mr.Argjent Xhelili, raportoi se sa i përket ftohjes shtesë, tashmë kemi marrëveshje për furnizim edhe të dy kondicionerëve të tjerë, ku pritet zgjerimi i kapacitetit për ftohje. Ai theksoi se për momentin, sistemi në dhomën e serverëve përdor dy kondicionerë të mëdhenj profesionalë, të cilët e mbajnë hapësirën në kushte të përshtatshme dhe theksoi edhe një herë se ky furnizim po kryhet veçmas nga furnizimi i pajisjeve IKT.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera të IKT.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera IKT për 2 (dy) vjet, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-3061/1 datë 21.7.2025, ndërsa mjete janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, përkatësisht ato do të sigurohen shtesë nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 7

Z. Trajçevski, në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, sqaroi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të ulët, që ka të bëjë me lyerjen e zyrave në katin e tretë të ndërtesës. Ai informoi se udhëheqësi Goran Radunović ka kontaktuar me disa kompani, por, për fat të keq, asnjëra prej tyre nuk ka paraqitur ofertë brenda shumës maksimale të lejuar prej 1.000 eurosh. Prandaj, në seancën e ardhshme, do të propozohet të kryhet furnizim publik, me qëllim që të sigurohet konkurrencë më e gjerë dhe t'u mundësohet disa kompanive të aplikojnë. Z. Trajçevski shtoi se procedura për furnizim publik do të zgjasë më shumë se furnizimi nën 1.000 euro, por është e nevojshme duke pasur parasysh se nuk është pranuar asnjë ofertë e përshtatshme. Në rast se do të ishte zgjedhur kompani brenda vlerës së parashikuar, puna mund të fillojë menjëherë.

Ai konkludoi se në seancën e ardhshme do të paraqitet propozim për zbatimin e furnizimit publik për rinovimin e zyrave në katin e tretë.

Z. Stefanovski pyeti nëse pika teknikisht do të tërhiqej nga rendi i ditës.

Z. Trajçevski sqaroi se nuk ka material konkret për këtë pikë sepse asnjë kompani nuk ka paraqitur ofertë, prandaj Këshilli nuk është në gjendje të marrë vendim ose të japë miratim.

Prandaj, z. Stefanovski e tërhoqi pikën "Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizime Publike" nga rendi i ditës për seancën e 6-të.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho Stefanovski